


Living



Arjola
James
2 hohësh



Arjola *mes* 2 kohësh

Kur traditat bëhen bashkë me modernen, kultura pasurohet akoma më shumë. Me këtë editorial, si një dhuratë nga Living për festat e 28-29 Nëntorit, pikërisht këtë jemi munduar të sjellim pranë lexuesve tanë: Bukurinë e një motivi të trashëguar nga e kaluara, sjellë si një element kyç në një kombinim tepër aktual të së tashmes.

Një sesion fotografik “street style”, tërësisht me një dukje autentike shqiptare, të kuruar në detaje me personazhin e këtij editoriali, Arjola Shehun.

Moderatorja shumë e dashur për publikun nuk mund t’i shpëtonte disa pyetjeve, si për lidhjen e saj me traditat e origjinën, ashtu edhe për projektet që viti i ri do të ketë rezervuar për të.

Ideja dhe Realizimi: Santana Çomora

Fotografia: Ergys Zhabjaku

Dizajni Grafik: Kostandin Feshti

Fashion Editor: Niko Komani

Editor: Kostandin Feshti / Xhoia Dumi

Kostumografia: Qëndistari Kazazi Erebara / Emin Kazazi

Make Up Artist: Suela Cangu



Veshja: Karl Lagerfeld; The Official Store, Bllok
Vëthët: Something Something
Varëset dhe Unazat: Swarovski; Qendra Metropol
Veshja tradicionale shqiptare nga zona e Labërisë: Qëndistari Kazazi Erebara

- Në lidhje me modelimin, si ka nisur rrugëtimi yt dhe a ke sfiluar ndonjëherë me kostume kombëtare?

Jeta ime si modele ishte sa jeta e një fluture në tokë. (qesh) Dua të them që zgjati shumë pak. Kam qenë imazh i brandeve dhe kompanive shumë prestigjioze në Shqipëri, por nuk ka qenë asnjëherë fokusi im të them të vërtetën! U gjenda krejt rastësisht, edhe pse të jem e singertë kam marrë komplimente të vlefshme në këtë fushë.

E sa për kostumet kombëtare, mbaj mend një aktivitet fantastik, ku Fadil Berisha për

Tirana Art Days, organizoi në Pallatin e Kongreseve një eveniment dedikuar stilistëve shqiptarë. Kështu që lidhja me rrënjët ishte shumë e bukur dhe e thellë për mua në atë moshë.

- Sa e lidhur je me traditën?

Me vitet, po afrohem më shumë me rrënjët e mia. Jam gjithnjë në kërkim të të mësuarit të historisë së familjes, vendit ku ata kanë jetuar, si kanë qenë traditat dikur dhe po e shijoj shumë këtë proces. Sigurisht, sytë janë nga e ardhmja, por nuk do të doja të harroja sa e rëndësishme është e shkuara në rrugëtimin tim jetësor.

- Sipas teje, cila zonë e Shqipërisë ka kostumet më të bukura?

Do të mbroj me fanatizëm zonën time (qesh). Jam një mbesë gjirokastre. Shumë mendojnë që unë apo prindërit e mi kanë lindur në Gjirokastrë. Në fakt jo, ne kemi lindur në Tiranë, unë shumë vonë e kam vizituar Gjirokastrën për herë të parë. E kam vizituar kur kam qenë 21 vjeçe. Gjyshërit e mi kanë ikur shpejt nga ajo zonë, por nuk kanë harruar të na kultivojnë dashurinë për atë



vend aq të veçantë, kështu që unë u rrita duke thënë që jam gjirokastrite.

Më duhet ta pranoj, teksa realizonim këtë kopertinë, unë u mrekullova nga detajet e motiveve kombëtare. Të gjitha zonat kanë veshje të jashtëzakonshme, por ndjeva emocion të veçantë teksa mbaja një histori 200-vjeçare në shpinë, mbi fustanin elegant të zi që e shoqëronte. Kështu që faleminderit Santës, Nikos, Evisit për këtë emocion.

- Lidhur me projektet e tua çfarë pret për 2025-ën?

Unë nuk kam një plan B. I vetmi plan A për mua është televizioni, kështu që besoj do të shihemi shumë shpejt në të. Më duhet ta pranoj se me vitet dhe përvojën, jam bërë shumë më përzgjedhëse, kam kërkesa më të larta nga vetja dhe për veten, kështu që ngjitja e majave nuk është e thjeshtë. Por, ne të Gjirokastrës jemi mësuar me malore, ndaj nuk na lodh e as demotivon pjerrësia, kështu që besoj: Shihemi bashkë në Maja! (qesh)

- E ke menduar ndonjëherë të largohesh nga Shqipëria?

Kurrë nuk e kam patur ëndrrën

amerikane, por e vërteta është që para një muaji e gjeta veten në dyert e ambasadës, duke kërkuar një vizë turistike. Me të gjithë zhgënjimet që sjell vazhdimisht, Shqipëria është vendi që dua dhe shpresoj që të mos mërzitem kurrë duke jetuar në të.

“Nuk do të rresht kurrë së bëri atë që di të bëj më së miri.”



Set: ELLA B Studio
Vëthët: Something Something
Varëset dhe Unazat: Swarovski; Qendra Metropol
Veshja tradicionale shqiptare nga zona e Shkodës: Qëndistari Kazazi Erebara

Për t'u rikthyer tek kostumografia si një element kyç i këtij seti fotografik, duhet thënë se nuk janë të paktë krijuesit e modës në botë që po i rikthehen çdo ditë e më shumë motiveve tradicionale vendase, të cilat falë etnografëve ruhen me fanatizëm e trashëgoohen brez pas brezi, si një gur i rëndë në themelin e identitetit kulturor. Shqipëria jonë nuk ka pak, madje, kostumet tona kombëtare të krahinave të ndryshme të vendit, cilësohen si disa nga më të bukurat në rajon. Ndaj, e mira nuk është t'i kremtojmë thjesht si një e shkuar mbresëlënëse, por t'i mbajmë gjallë në krijimet e kohës, duke ndriçuar atë pjesë të kulturës sonë, të panjolllosur nga asnjë anë.

Iniciativat lidhur me këtë synim, vitet e fundit janë shtuar, si nga disenjatorë vendas, ashtu dhe nga institucionet e ndryshme që mbështesin këtë ideal. Nuk duhet të harrojmë se kemi plot zakone, motive, tradita, shumë prej të cilave janë unike, karakterizuese, interesante dhe mbi të gjitha mbresëlënëse.

**Gëzuar 28-29 Nëntorin,
Living!**





Kostumi: ELLA B Studio
Vëthët: Something Something
Varëset dhe Unazat: Swarovski; Qendra
Metropol
Veshja tradicionale shqiptare nga zona e
Tropojës: Qëndistari Kazazi Erebara



Fustani: ELLA B Studio
Vëthët: Something Something
Varëset dhe Unazat: Swarovski; Qendra
Metropol
Veshja tradicionale shqiptare nga zona e
Gjirokastrës: Qëndistari Kazazi Erebara

